



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obština-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.3. pikën a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik N.T.SH. "Office-trade" Arbnora Aliu B.I. të datës 28.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET pjesërisht** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.T.SH. "Office-trade" Arbnora Aliu B.I. kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 25.04.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik N.T.SH. "Office-trade" Arbnora Aliu B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik N.T.SH. "Office-trade" Arbnora Aliu B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 28.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje rekuizita sportive dhe pajisje të tjera për IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-1280-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 037 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:**

**Pretendimi i parë (I)** - Komisioni i vlerësimit ka shpallur si fitues OE më të shtrejtë (sesa parashtruesi).

**Pretendimi i dytë (II)** - parashtruesi nuk pajtohet me faktin se komisioni i vlerësimit përmes raportit të vlerësimit ka gjetur se çmimi i ofertuar nga parashtruesi është jonormalisht i ulët.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 69 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 04.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 22.02.2023.
- Dosja e tenderit e dt. 23.02.2023.
- Oferta e parashtruesit.
- B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve i dt. 23.03.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 24.04.2023.
- Letra standarde e kërkesës mbi tenderët jonormalisht të ulët të dt. 04.04.2023.
- Përgjigja në kërkesën mbi tenderët jonormalisht të ulët të dt. 06.04.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 25.04.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 25.04.2023.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme si dhe ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin e dytë. Po ashtu nga provat e administruara është arritur që të vërtetohet pretendimi i dytë i parashtruesit në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.3. pikës a) të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme si dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin e parë. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet pretendimi i parë i parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafit d) të RRPP.

## Pretendimi i pabazuar

Lidhur me pretendimin e parë duhet cekur se sipas nenit 60 paragrafit 1 nënparagrafit 1 përcaktohet se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Në rastin konkret tenderuesi që është rekomanduar për dhënie të kontratës përmes raportit të komisionit vlerësues është gjetur se ka qenë **tenderi i përgjegjshëm** me çmimin më të ulët. Fakti që ka pasur tender të papërgjegjshëm me çmim më të ulët nuk përbën shkelje të nenit 1 të LPP sikurse pretendohet nga parashtruesi. Prandaj pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

## Pretendimi i bazuar

- **Lidhur me pretendimin e dytë** ku parashtruesi konsideron se komisioni gabimisht ka gjetur se çmimi i ofertuar prej tij është jonormalisht i ulët, fillimisht duhet cekur se çështja e çmimit jonormalisht të ulët është e rregulluar me nenin 61 të LPP dhe me nenin 41 të RRPP. Përmes nenit 41 paragrafit 41.2 të RRPP përcaktohet se “Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët”. Sidoqoftë duhet cekur që përmes nenit 41 paragrafit 41.6 të RRPP përcaktohet se “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët”. Bazuar në këtë dispozitë autoriteti kontraktues me datë 04.04.2023 ka dërguar te parashtruesi Letrën standarde të kërkesës për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët. Ndërsa me datë 06.04.2023 parashtruesi ka dorëzuar përgjigjen në këtë kërkesë të autoritetit kontraktues. Përgjigja e parashtruesit është manifestuar si deklaratë me shkrim e cila ka përfshirë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit duke përfshirë shpjegimin mbi çmimet për të cilat është dyshuar se janë jonormalisht të ulta duke bashkangjitur se bashku me përgjigjen edhe DUD – Dokumentet Unike Doganore dhe disa fatura nga furnizuesit e parashtruesit. Po ashtu është referuar edhe te disa aktivitetet e ngashme të prokurimit që ka zhvilluar Komuna e Prishtinës si autoritet kontraktues ku janë shpallur si fitues operatorët ekonomik të cilët sipas parashtruesit kanë ofertuar me çmime të ngjashme sikurse parashtruesi.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.8 të RRPP përcaktohet se “Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: **a.** ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; **b.** çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; **c.** çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose **d.** origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara”.

Njëkohësisht përmes nenit 41 paragrafit 41.9 përcaktohet gjithashtu se “Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet”.

Në raportin e komisionit vlerësues si dhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, lidhur me parashtruesin komisioni ka evidentuar se “ju keni bashkangjitur ofertën nga një furnizues të cilat janë të porsyeshme dhe jo bindëse për AK-në andaj rrjedhimisht jeni të eliminuar për këtë aktivitet”. Fillimisht kur është përdorur termi “paarsyeshme” komisioni është dashur të ofroj sqarime pse përgjigja e parashtruesit si e tillë është paarsyeshme. Për më tepër, komisioni ka njoftuar se përgjigja e parashtruesit nuk është bindëse mirëpo nuk ka treguar arsyet pse një përgjigje e tillë nuk qenka bindëse për autoritetin kontraktues.

Duhet theksuar se diskrecioni për të vlerësuar përgjigjet e operatorëve ekonomik në raste të tilla nuk është diskrecion absolut. Me fjalë të tjera ekzistojnë rregulla juridike në fuqi sipas të cilave duhet vepruar në situata të tilla. Në asnjë formë nuk mund të thuhet se një përgjigje nga një operator ekonomik nuk është bindëse pa treguar arsyet pse kjo përgjigje nuk qenka bindëse. Sa i përket rastit konkret, këto dispozita i referohen nenit 41 paragrafëve 41.8 dhe 41.9 të RRPP ku përcaktohet se me rastin e vlerësimit të përgjigjes së tillë nga parashtruesi komisioni vlerësues duhet që të marrë parasysh por pa u kufizuar në gjashtë (6) kritere të cilat janë:

1. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar;
4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara;
5. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.


Në rastin konkret sqarimet e ofruara nga komisioni vlerësues nuk kanë evidentuar fare këto kritere të përcaktuara me nenin 41 par. 41.8 dhe 41.9 të RRPP por vetëm ka evidentuar se “përgjigja nuk është bindëse”. Në këtë mënyrë komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim pikërisht me nenin 41 par. 41.8 dhe 41.9 të RRPP. Përndryshe një veprim i tillë është në kundërshtim edhe parimet themelore të prokurimit publik për ekonomikitet, barazi në trajtim (mosdiskriminim), transparencë dhe llogaridhënie sikurse përcaktohet me nenet 6 dhe 7 lidhur me nenin 59 të LPP. Prandaj pretendimi i dytë i parashtruesit është prentedim i bazuar.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.3. nënparagrafin a) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 05.05.2023**

**Visar SHEHU**  
  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.